



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Nr. 1580 Prot

Tiranë, më 07/09/2021

Nr. 590 Prot

Tiranë, më 04/04 /2021

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI**

**Mbi**

**“BASHKËPUNIMIN DHE NDËRVEPRIMIN NDËRINSTITUCIONAL”**

**Tiranë, Prill 2021**

**Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**, përfaqësuar nga Kryetari, z. Gentian Sala, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

*dhe*

**Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)**, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Andrea Maliqari, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

Nisur nga interesi dhe dëshira e mirë e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, për të bashkëpunuar, nëpërmjet realizimit, organizimit dhe promovimit të veprimtarisë kërkimore, akademike; rritjes së kapaciteteve njerëzore teknike në fushën e mediave audio/audiovizive; krijimin e hapësirave mbështetëse në veprimtaritë trajnuese, praktikave mësimore të studentëve e më gjerë; nxitjen e aktiviteteve të tjera që lidhen me zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në industrinë e mediave audio/audiovizive; si dhe rritjen e mbështetjes së kërkimit shkencor në funksion të orientimit të çështjeve rregullatore në tërësi.

Duke synuar rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, me qëllim përmirësimin e dialogut ndërmjet dy institucioneve (rregullatorit dhe botës akademike).

Me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin në drejtime konkrete, bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Mirëkuptimi (më poshtë Marrëveshja).

## **Neni 1 Objekti**

Kjo Marrëveshje do të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve dhe do të thjeshtojë komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me fushat me interes të përbashkët me qëllim realizimin, organizimin dhe promovimin e kërkimeve në lidhje me çështjet e mediave audio/audiovizive, bashkëpunimin dhe mbështetjen e studimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimit.

## **Neni 2 Fusha e bashkëpunimit**

AMA dhe UPT, do të bashkëpunojnë në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi të fushave përkatëse gjatë proceseve të punës së përbashkët të dy institucioneve.

Bashkëpunimi do të fokusohet në sa më poshtë:

- Angazhimin reciprok me qëllim nxitjen, mbështetjen dhe promovimin e veprimtarive kërkimore dhe studimore në lidhje me çështjet teknike, rregullatore në fushën e mediave audio/audiovizive.
- Realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, sipas një plani pune të përcaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet.
- Organizimin e takimeve të përbashkëta me pjesëmarrjen e ekspertëve të dy institucioneve për realizimin e tryezave të rrumbullakta, trajnimeve, seminareve dhe workshop-ëve.

- Vënien në dispozicion të njohurive në fushën e transmetimeve audiovizive për qëllime kërkimore dhe studimore.
- Mbështetjen në zhvillimin e projekteve të përbashkëta shkencore dhe kërkimore në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Hulumtimet e përbashkëta shkencore do të kryhen në marrëveshjet e ndërsjellta ndërmjet departamenteve përgjegjës të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (UPT) dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- Shkëmbimi i përvojës praktike të çështjeve rregullatore dhe teknike të brezit frekuencorë audio/audiovizivë, me qëllim mbështetjen e studentëve të rinj në kryerjen e praktikave mësimore pranë ambjenteve të AMAs.
- Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera për të cilat mund të bihet dakord në të ardhmen për të ndihmuar veprimtaritë mbështetëse në sektorin e mediave audio/audiovizive.

### **Neni 3 Koordinimi midis palëve**

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarët e institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
5. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
  - a. Për FTI-ne (UPT): Prof. Asoc. Aleksander Biberaj - abiberaj@fti.edu.al
  - b. Për AMA-n: Ing. MSc. Elkeda Domi - elkeda.domi@ama.gov.al;

### **Neni 4 Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti**

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshje do të përdorë informacionin e marrë vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.
2. Veprimet nga palët nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

### **Neni 5 Takime të përbashkëta**

1. Çdo 6 muaj titullarët e të dy institucioneve do të zhvillojnë takime për të diskutuar ecurinë e implementimit të kësaj marrëveshjeje, me qëllim që të ndërtohet një sferë sa më e sigurt dhe efikase, duke përcaktuar drejtimit për të garantuar zbatimin e veprimtarive studimore dhe kërkimore në sektorin e transmetimeve.

*nh*

2. Me iniciativën e secilës palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe me nivelet hierarkike të ndryshme përveç titullarëve.

**Neni 6**  
**Përmirësimet dhe ndryshime**

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e palëve të kësaj Marrëveshje, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

**Neni 7**  
**Afati i Marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 8**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Universiteti Politeknik i Tiranës dhe dy të tjera pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Palët lexojnë, kuptojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, duke pranuar kështu kushtet e saj, në dhe për interes të qëllimeve që përfaqësojnë.

PËR  
AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KRYETARI  
GENTIAN SALA



PËR  
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

REKTORI  
PROF. DR. ANDREA MALIQARI

